



BalkanSport shpk, distributori zyrtar i markave të mirënjohura sportive si **adidas**, **Reebok**, **Head**, **Mares** dhe **Givova** për Shqipërinë; dhe gjithashtu përfaqësues zyrtar i rrjetit multibrand sportiv **INTERSPORT** dhe **The Athlete's Foot**, ofron **Internship** për kandidatët e interesuar në pozicionin:

Assitent/e Kategorie.

Asistenti/ja i Kategorisë është pjesë e skuadrës së Shitjeve në departamentin Commercial Operations, raporton tek Menaxheri i Shitjeve. Asistenti/ja e kategorisë asiston në hedhjen në treg të produkteteve të kërkuara nga klientët.

Roli dhe Përgjegjësitë:

- Analizon produktet e shitura për të parashikuar tendencat e blerjeve nga klientët.
- Bashkëpunon me skuadrën e marketingut për fushatat e marketingut në lidhje me Brand-in.
- Kryen kontrolle të dyqaneve dhe mbledh informacion nga Menaxherët e Dyqaneve.
- Asiston në bashkëlidhjen e Strategjisë së Brand-it me vlerat, qëllimet, misionin e Kompanisë.
- Asiston në organizimin e transportit të artikujve duke kontaktuar kompanitë/agjensitë e transportit.
- Përkthen dokumentacionet e nevojshme për kryerjen e procedurave të ndryshme doganore.
- Rakordon lëvizjet e mallit në pikat e shitjes duke u bazuar në shitjet e tyre.
- Njofton departamentet përkatëse dhe sigurohet që produkti/marka të dorëzohet në kohë.

Aftësitë:

- Aftësi analitike dhe krijuese shumë të mira.
- Aftësi shumë të mira negociuese dhe krijimin e një network-u sa më të gjerë.
- Aftësi për të menaxhuar kohën, të jetë i besueshëm, ambicioz dhe të ketë etikë në punë.
- Aftësi të mira organizative në zgjidhjen e situatave të ndryshme.
- Njohuri ekselente të gjuhës angleze.
- Të jetë i gatshëm të përshtatet dhe të marrë përgjegjësi.
- Të jete i aftë të punojë në grup dhe individualisht dhe nën presion.
- Të posedojë leje drejtimi automjeti.

Edukimi dhe Kualifikimet:

- Arsimi i lartë në fushën e Administrimit Biznes, Marketing ose fusha të ngjashme.
- Ekspierencë pune në këtë profil ose të ngjashëm përbën avantazh.
- Të jetë njohës shumë i mirë i Excel-it dhe programeve kompjuterike.

Pas përfundimit me sukses të Internship-it (praktikës) dhe vlerësimit të performancës ofrohet mundësia e punësimit pranë kompanisë.

Kandidatët e interesuar për pozicionin e mësipërm, duhet të dërgojnë CV-në deri më,
datë **30 Qershor 2020** në adresat e-mailit: hr@balkansport.al

Balkan Sport HR Team